VENDIM
Nr. 148, datë 10.6.2022

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN MAJ 2022

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.6.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 900/4 prot., datë 9.6.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin maj 2022",

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 4002 prot., datë 30.5.2022, protokolluar në ERE me nr. 656 prot., datë 1.6.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 18,97 lekë/kwh, për muajin maj 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20 kV, 10 kV, si dhe 6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 4049 prot., datë 31.5.2022, protokolluar në ERE me nr. 886 prot., datë 3.6.2022, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike prej 32,85 lekë/kwh, për muajin maj 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Shoqëria ka kërkuar njohjen e kostove administrative në vlerën 1.77 lekë/ kwh.
- Bazuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, kostot administrative të përllogaritura për aktivitetin e furnizimit për periudhën 1 maj – 31 dhjetor 2022, janë vlerësuar 1,06 lekë/kwh.
- Në lidhje me komponentët e tjerë të përllogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF, për muajin maj 2022, evidentojmë se në përputhje me nenin 9, të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin maj 2022, janë: kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike, kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit dhe tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes.
- Në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin maj 2022, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për nivele tensioni për muajin Maj 2022				
MAJ 2022			Nivelet e tensionit	
			35 kV	20/10/6 kV
		Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	27.84	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.84	0.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55	3.99
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		**Leke/kWh**	**32.14**	**18.26**

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse dhe në të dhënat e paraqitura në aplikime, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin maj 2022, do të jetë:

- 32.14 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;
- 18.26 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin maj 2022, prej:

- 32.14 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV;
- 18.26 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti